**E.S Financial Advisory shpk**
**Erjon Saraçi – AUDITUES LIGJOR**
**Licensa Nr.260, Date 27.08.2012**
**Adresa: Rruga Tefta Tashko Koço, Pall 132, Ap 1, Tirane**
**Mob. 0696002295**
**e-mail: erjons@gmail.com / officecloud.adv@gmail.com**

**Tiranë, më 27.04.2024**

**Lënda:** **Informacion në lidhje me mosrealizimin e shërbimit të auditimit të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga subjektet zgjedhore per zgjedhjet e organeve te qeverisjes vendore te dates 14 Maj 2023,si dhe per zgjedhjet e pjesshme vendore ne bashkine Kukes te dates 24 Shtator 2023 , Partia Lëvizja Punëtore Shqiptare.**

**Për:** **Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve**
**Rruga "Ibrahim Rrugova", Nr. 4, Tiranë, Shqipëri**

Të nderuar zotërinj,

Sipas kontratës nr.888 prot. datë 2.4.2024 ,me palën angazhuese KQZ-në, me objekti misioni të auditimit "*Kryerja e auditimit të detyrueshëm te partive politike të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga subjektet zgjedhore per organet e qeverisjes vendore te dates 14 maj 2023 ,si dhe per zgjedhjet e pjeshme vendore ne bashkine Kukes te dates 24 shtator 2023 në përputhje me ligjin nr. 8580, datë 17.02.2000 "Për partitë politike'', i ndryshuar, aktet nënligjore të KQZ-së të miratuara për këtë qëllim, ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratur", i ndryshuar, dhe ligjin nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", si dhe aktet nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tyre"* jemi caktuar me cilësinë e ekspertit kontabël (audituesit ligjor) për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023 të subjektit zgjedhor "Partia Lëvizja Punëtore Shqiptare".

Menjëherë pas lidhjes së kontratës me KQZ-në, ne kërkuam të vendosim komunikimin zyrtar me Partinë Lëvizja Punëtore Shqiptare për fillimin e proçedurave të auditimit, nëpërmjet komunikimit me telefon dhe dërgimit me poste elektronike dhe fizike të letres me kthim përgjigje, në adresën e emailit dhe selisë së partisë.

Nepermjet komunikimeve, Ne na eshte konfirmuar se shkresa – kerkese per informacion eshte marre nga kryetari i partisë Z. Genci Sakaj. Qe nga ai moment nuk kemi marre asnje informacion apo evidence per çka i kemi kerkuar per te kryer auditimin.

Ne i kemi ri-derguar nje email te dyte me date 24 Prill 2024 per te na derguar informacionin e kerkuar, por deri me sot nuk kemi asnje pergjigje qofte me telefon ose nepermjet emailit.

Ne kërkuam edhe në faqen zyrtare të KQZ-së për raportimin financiar të fondeve të fushatës të datës 14 Maj 2023 të subjekteve zgjedhore por nuk gjetëm ndonjë raport financiar në lidhje me subjektin Partia Lëvizja Punëtore Shqiptare. (b/ngjitur)

Gjithashtu edhe nga raportet e monitorirmit nuk rezultoi ndonjë gjetje.

Bashkangjitur dokumentacioni vërtetues:

- Letra e dërguar me postë bashke me konfirmimin e shërbimit postar për vënien në dijeni të proçesit të auditimit të fondeve të fushatës të datës 14 Maj 2023.
- E-maili i derguar ne adresën e partisë :Idajetbeqiri@hotmail.com
- Kerkimi ne faqen e KZQ per Raportim Financiar

Posta e derguar ne adresën e partisë: Lagja "Lirim", rruga Beqir Sulo Agalliu, banesa 814/1, Vlorë

Ju faleminderit për mirëkuptimin!
**E.S Financial Advisory shpk**
**Erjon Saraçi – AUDITUES LIGJOR**

E.S.FINANCIAL ADVISORY
Sh.p.k.
NUIS : K 82230010 B
TIRANA - ALBANIA

**E.S Financial Advisory shpk**
**Erjon Saraçi – AUDITUES LIGJOR**
**Licensa Nr.260, Date 27.08.2012**
**Adresa: Rruga Tefta Tashko Koço, Pall 132, Ap 1, Tirane**
**Mob. 0696002295**
**e-mail:** **erjons@gmail.com** / **officecloud.adv@gmail.com**

---

**Tiranë, më 11.04.2024**

**Lënda: Kërkesë për fillimin e procedurave të auditimit ligjor**

**Për: Partia Lëvizja Punëtore Shqiptare**
**Drejtuar kryetarit: Z. Genc Sakaj**
**Adresa e selisë: Lagja "Lirim", rruga Beqir Sulo Agalliu, banesa 814/1,Vlorë**

Sipas kontratës nr.888 prot. datë 2.4.2024 ,me palën angazhuese KQZ-në, objekti i misionit të auditimit eshtë: *"Kryerja e auditimit të detyrueshëm te partive politike të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga subjektet zgjedhore per organet e qeverisjes vendore te dates 14 maj 2023 ,si dhe per zgjedhjet e pjeshme vendore ne bashkine Kukes te dates 24 shtator 2023 në përputhje me ligjin nr. 8580, datë 17.02.2000 "Për partitë politike'', i ndryshuar, aktet nënligjore të KQZ-së të miratuara për këtë qëllim, ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratur", i ndryshuar, dhe ligjin nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", si dhe aktet nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tyre"* dhe afati kufi i përfundimit të procesit te auditimit eshte data 1.5.2024

Për kryerjen me sukses të misionit, brenda kohës së përcaktuar në kontratë, ne presim bashkëpunim tuaj dhe të personelit që merret me shërbimin kontabël për të na berë të disponueshëm dokumentacionin kontabël, rregjistrimet dhe informacione të tjera që do të kërkohen në lidhje me auditimin tonë.

Ju lutem konfirmoni marrjen e kërkesës dhe na krijoni mundësinë e një takimi në selinë e partisë tuaj sa më shpejt të jetë e mundur, për të përcaktuar termat e angazhimit të auditimit.

Përgjigjen drejtojeni në adresën në krye të shkresës.

Faleminderit!

**E.S Financial Advisory shpk**
**Erjon Saraçi – AUDITUES LIGJOR**

E.S.FINANCIAL ADVISORY
Sh.p.k.
NUIS : K 82230010 B
TIRANA - ALBANIA

Zyra Postare 5
AL
12-04-2024
1001
Tiranë

Nr: 1001

**DEFTESE** 12/04/2024 11:56:18

**PRANIMI E OBJEKTEVE POSTARE**

| | |
|---|---|
| Objekti | Letra Leter |
| KOD-BAR | RR598114140AA |
| Derguesi | E.S. FINANCIAL ADVISORY SHPK |
| Marresi | PARTIA LEVIZJA PUNETORE SHQIPTARE |
| Vend Mberritja | VLORE |
| Pesha | 19 gr |
| **Sherbime te vecanta** | **35** |
| Zarf i madh A4 23 x 33 | 35 |
| Tarifa Shtese | 70 |
| Tarifa Postare | **105** |
| **Tarifa Totale** | |

Nenshkrimi: Marjola Odobashi

Gmail **Audit & Advisory Office <officecloud.adv@gmail.com>**

# Kerkesa per Informacion per auditimin e Partise per zgjedhjet 14 Maj 2023

2 messages

**Audit & Advisory Office** <officecloud.adv@gmail.com> Fri, Apr 12, 2024 at 11:14 AM
To: genci-sakaj@hotmail.com

Pershendetje Z.Sakaj,
Po ju dergoj shkresen - Kerkese per Informacion per auditimin e Partise per fushaten zgjedhore 14 Maj 2023, per Partine Lëvizja Punëtore Shqiptare.
Ju lutem na dergoni;

1. Raportin Financiar te derguar ne KQZ (raport i pergatitur sipas formatit te derguar nga KQZ) i pergatitur nga financiari i Partise per zgjedhjet e 14/5/2023
2. Llogarine bankare te Partise nga data 1/1/2023 deri 31/10/2023
3. Librin e Arkes per periudhen 1/1/2023 deri 31/10/2023
4. Nje ekstrakt nga gjykata Vlore (zyra per OJF-te) per subjektin Lëvizja Punëtore Shqiptare.
5. Nje liste te detajuar te shpenzimeve (ne excel) te bera per fushaten per zgjedhjet e 14/5/2023.
6. Kush jane personat qe kane te drejte veprimi ne llogarine bankare te Partise?

Shkresa b/ngjitur ju eshte derguar dhe me poste.

Do organizohemi dhe per te kryer nje takim bashke.

Erjoni
--
Faleminderit
E.S Financial Advisory sh.p.k.
officecloud.adv@gmail.com
Nr Zyra: 0673055055
Nr. Admin 0696002295

Virus-free.www.avast.com

**Shkrese_kerkese per Info.pdf**
202K

**Audit & Advisory Office** <officecloud.adv@gmail.com> Wed, Apr 24, 2024 at 9:37 AM
To: genci-sakaj@hotmail.com

Pershendetje!

po ju shkruajme perseri nje email te 2-te ne lidhje me dhenien e informacioneve sic kerkuar ne emailin e dates 12 Prill. Para se te kryejme nje takim ne seline e Partise

ju lutem na mundesoni kete informacion deri ne fund te kesaj jave (Premte 26 Prill) sepse Ne duhet te mbyllim sa me shpejt procesin e auditimit dhe raportojme ne KQZ.

--
Faleminderit
E.S Financial Advisory sh.p.k.
officecloud.adv@gmail.com
0673055055

[Quoted text hidden]

---

**Shkrese_kerkese per Info.pdf**
202K

Raporti financiar vjetor

2023

Lëvizja Punëtore Shqiptare

Apliko Filtrat

Pastro Filtrat

| Id | Emërtimi | Partia Politike | Viti | Veprimi |
|---|---|---|---|---|
| Nuk u gjet asnjë rekord. | | | | |